



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA, MUNICIPAL VITI
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

04.Nr.48/18

Më datë :04.12.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Nenit 14. par.2. të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L125, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik , Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, Nenit 46 të Rregullores mbi Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës në QKMF nr.238 datë 27.10.2011, Vendimit të Inspektoratit të Punës nr.465/2018 datës 17.10.2018, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti
Titulli i vendit të punës: Teknikë i Dhëmbëve 2 (dy) pozita .
Kategoria dhe grada e vendit të punës: - Koeficienti – 4.80, H-68
Orari: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Punës nr. 03/L-212

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Kujdeset për mjetet e punës dhe materialet e punës;
Bene pastrimin dhe sterilizimin e instrumenteve dhe jep përgjegjësi për efikasitetin e tyre;
Bashkëpunon me mjekun stomatolog;
Kujdeset për mirëvajtjen e aparaturave stomatologjike;
Si dhe pune të tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi etj.

Për vendin e punës Teknikë i Dhëmbëve kërkohet:

- Shkollën e Mesme të Mjekësisë – drejtimi, teknik i dhëmbëve.
- Kandidati/ja duhet të ketë Licencën e Punës.

Dokumentet e kërkuara për të gjithë kandidatët:

- Kopjet e dokumentacionit të kualifikimit (Diploma e shkollës së mesme të mjekësisë-drejtimi, teknik i dhëmbëve).
- Kopjen e licencës së punës
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.
- Ekstrakti i lindjes,
- Çertifikatën që ndaj tij/saj nuk zbatohen hetimet,
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme

Komuna e Vitisë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e pa kompletuara sipas konkursit si dhe ato që arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Detyrat e punës për profilin e kërkuar janë parashikuar me Rregulloren mbi Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës në QKMF .

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Arhivës të Komunës së Vitisë nr.1

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes.